

**VENDIM**  
**Nr.241, datë 21.5.2004**

**PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT**  
**“TV CHANNEL 7”**

**SUBJEKTI: ZNj. ORJANA CENKO**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radiotelevizive”, të miratuar në vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit, Znj. Orjana Cenko, me vendndodhje në qytetin e Gjirokastrës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca e bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Sefedin Çela**